



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategoritë e ndryshme ekonomike në vlerë 509,160€.
- A1 Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar ishin të nënvlerësuar për 112,905€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Klinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Lidhja e kontratave për punë me çmim për njësi jo në pajtim me Rregulloren e Prokurimit Publik.
- B2 Tejkallim në realizimin e sasive të kontratës publike kornizë, në mospërputhje me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit.
- A3 Komisioni i vlerësimit kishte përfshirë kritere shtesë gjatë vlerësimit të aplikacioneve të fermerëve, të cilat nuk ishin paraparë në thirrjen publike.
- A4 Tejkallim i afatit ligjor për pozitat me ushtrues detyre.
- B3 Vonesa në pagesën e obligimeve të papaguara.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Klinës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Klinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Klinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Klinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Klinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keqklasifikim të shpenzimeve, raportim jo i saktë i detyrimeve kontingjente, dobësi në menaxhimin e kontratave publike, vonesat në kryerjen e punëve, mos raportimi i menaxhereve të kontratave në sistemin e-prokurimit, si dhe mungesa e ndërmarrjes së veprimeve në për mbledhjen e borxheve, si dhe vlerësim i aplikacioneve të fermerëve jo sipas kriterëve të vendosura në thirrje publike, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm. Gjatë vitit 2025, nga Thesari ishin bërë pagesa në vlerë 609,160€, si rezultat i procedurave përmbartimore dhe vendimeve gjyqësore. Prej tyre borgji kryesor ishte 412,012€, ndërsa 197,148€, ishin pagesa shtesë në emër të kamatave, tarifave të përmbartimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore. Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, një (1) pjesërisht i përsëritur dhe gjashtë (6) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike

Gjetja

Ligji mbi Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332 neni 15 paragrafi 12 përcakton se, ndarjet buxhetore nga rezerva me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ.

Si dhe bazuar në qarkoren buxhetore me Nr. 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) pika 3 kufijtë buxhetor për komunat, në kolonën rezerva komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontingjente mjetet për ndarjen për detyrime kontingjente duhet ti marrin brenda kufijve të ndarë buxhetor për komunat, duke përjashtuar kategorinë paga dhe shtesa.

Gjithashtu neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se "shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë.

Sipas shënimeve të ofruara nga komuna për vitin 2025, ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë totale prej 509,160€. Nga kjo shumë, Thesari kishte realizuar pagesa në bazë të vendimeve përmbartimore/gjyqësore për shujta, kualifikimin e arsimtarëve, si dhe shpenzimet e inflacionit dhe udhëtimit të arsimtarëve nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë prej 335,097€.

Po ashtu, nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve janë paguar

99,231€ për shujta, kualifikimin e arsimtarëve, si dhe shpenzimet e inflacionit dhe udhëtimit.

Për më tepër, nga kategoria e investimeve kapitale, në bazë të vendimeve përmbarimore/gjyqësore, janë paguar 73,297€ për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga komuna ndaj Shoqërisë Publike Vendore "Stacioni i Autobusëve", lidhur me rrënimin e objektit të Stacionit të Autobusëve në Klinë. Këto shpenzime, për nga natyra, klasifikohen si mallra dhe shërbime. Më tutje, ishin paguar 1,535€ nga kategoria mallra dhe shërbime për projektin kapital "Asfaltimi i rrugës dhe infrastrukturës nëntokësore në fshatin Poterq faza 2".

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte marrë parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore për të bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-e.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që, me rastin e përgatitjes së buxhetit të merr parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të MFPT, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Nënvlërësim i detyrimeve kontingjente

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatrat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare". Po ashtu neni 18 i kësaj rregullore parasheh "Organizatrat buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente".

Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar ishin të nënvlerësuar për 112,905€. Ky nënvlerësim ishte si rezultat i mos azhurnimit të regjistrit të detyrimeve kontingjente dhe mos përfshirjes së shpenzimeve të procedimit të gjykatave.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos evidentimit dhe përditësimit të saktë të detyrimeve kontingjente nga ana e përfaqësuesit ligjor të komunës.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit, përkatësisht shfrytëzuesit e RVF-së, të mos informohen drejt dhe saktë lidhur me vlerën reale të detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së RVF-së, detyrimet kontingjente të vlerësohen dhe të raportohen sakët nga përfaqësuesi ligjor i komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Lidhja e kontratave për punë me çmim për njësi jo në pajtim me Rregulloren e Prokurimit Publik

Gjetja

Rregullorja Nr. 001/2022 e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik neni 14 paragrafi 14.4 nën paragrafi c parasheh “Kontrata për punë ka si qëllim kryesor: 1) ekzekutimin, ii) projektimin dhe ekzekutimin, ose iii) realizimin me çfarëdo mënyre të një pune, ndërtimi ose aktivitete të inxhinierisë civile, përfshirë: ndërtime, restaurime, riparim ose demolim të objekteve, hapësirave, strukturave të inxhinierisë civile, ose ndonjë pjesë të tyre”. Po ashtu neni 54.15 i Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik ndër të tjerash parasheh se “Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për llojet e kontratave për furnizime dhe shërbime”.

Zyra e Prokurimit gjatë vitit 2025 kishte lidhur gabimisht pesë (5) kontrata për punë me çmim për njësi, ndonëse një formë e tillë e kontraktimit nuk është e paraparë me Rregulloren e Prokurimit Publik pasi që kontrata publike kornizë me çmime për njësi mund të udhëhiqen vetëm për llojet e kontratave për furnizime dhe shërbime, por jo edhe për punë.

Katër (4) nga këto kontrata kishin të bënin me mirëmbajtjen e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollave, të ndara në katër (4) Lote*, me çmim të përgjithshëm prej 260,000€. Në secilin llot ishte paraparë çmimi i përgjithshëm dhe çmimi për njësi.

Kontrata tjetër, e lidhur po ashtu si kontratë për punë me çmim për njësi, kishte të bënte me Rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje dhe rasteve të tjera sipas nevojave të inspektoratit, me çmim të përgjithshme prej 20,000€ dhe me çmim për njësi prej 118€.

Lidhja e kontratave për punë me çmime për njësi nuk është në përputhje me dispozitat e Rregullores së Prokurimit Publik, pasi kjo formë kontraktimi parashihet vetëm për kontratat e furnizimeve dhe shërbimeve

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta të brendshme gjatë fazës së përgatitjes së dosjes së tenderit, si dhe mungesës së monitorimit nga ana e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit për të zbatuar kërkesat e specifikuar në Rregulloren.

Ndikimi

Përdorimi i gabuar i kontratave me çmim për njësi për punë krijon vështirësi në menaxhimin e kontratës, pasi mungesa e sasive të sakta të përcaktuara në paramasë mund të rezultojë në tejkalime të paparashikuara ose dështim në realizimin e plotë të punimeve sipas nevojave reale.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë që Zyra e Prokurimit t'i zbatojë me përpikëri kërkesat e Rregullores, duke u siguruar që kontratat për punë të mos lidhen me çmime për njësi, por të kontraktohen me paramasë dhe paralogari të sasive të planifikuara në mbështetje të projektit kryesor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Tejkallim në realizimin e sasive të kontratës publike kornizë, në mospërputhje me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit**Gjetja**

Rregullorja Nr. 001/2022 e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, neni 17.35, përcakton se "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshën në bazë të rëndësisë të secilës "kategori të shërbimeve" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në bazë të poentimit. Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të autoritetit kontraktues".

Në kontratën publike kornizë "Ofrimi i shërbimeve shëndetësore, kujdesi paliativ" në vlerë të parashikuar prej 550,000€, dhe kohëzgjatje të kontratës 36 muaj, e cila kontratë deri në përmbyllje në vitin 2025 ishte realizuar në vlerë prej 549,474€ apo rreth 100%. Kishte tejkallim të sasive të faturuara dhe paguara tek pozicionet si në vijim:

Pozicioni 4 "Shërbimet sociale në teren" sipas dosjes së tenderit ishte dhënë pesha prej 5% apo 27,500€ për pozicion në bazë të rëndësisë. Nga analiza e realizimit për këtë pozicion deri në përmbyllje të kontratës gjatë vitit 2025, ishte faturuar dhe paguar vlera 283,075€ apo 52% e totalit të shpenzimeve për kontratën; dhe

Pozicioni 5 "Shërbimet sociale të kujdesit parësor shëndetësor në KPSH/QMKF/AMF", sipas dosjes së tenderit ishte dhënë pesha prej 5% apo 27,500€ për pozicion në bazë të rëndësisë. Ky pozicion deri në përmbyllje të kontratës gjatë vitit 2025 ishte faturuar dhe paguar 248,775€ apo 45% e totalit të shpenzimeve për kontratën.

Këto tejkallime kishin ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave dhe përcaktimit jo të duhur të peshimit të kategorive në bazë të rëndësisë së punëve/shërbimeve në dosjen e tenderit, por edhe të menaxhimit jo të duhur të kontratës.

Ndikimi

Tejkallimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që i'u është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Po ashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luaj një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të komunës, në mënyrë që këto kontrata të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit. Po ashtu duhet të sigurojë që të mos tejkallohen sasi të parashikuara me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mosvlerësimi i aplikacioneve të fermerëve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike.**Gjetja**

Rregullorja Komunale për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve neni 14 ndër tjerash parasheh se përzgjedhja e përfituesve bëhet nga komisioni në bazë të ftesës për publikim. Sipas Thirrjes Publike të datës 15.10.2025, për subvencionimin e fermerëve me pajisje bujqësore, përkatësisht freza për traktor 2 m dhe 1.65 m, spërkatëse dhe motokultivatorë, ndër të tjera kërkohet që përfituesi të jetë banor i komunës, të posedojë sipërfaqe toke dhe të ketë traktor. Gjithashtu, përfituesi duhet të ishte i gatshëm të participonte me 30% të kostos së pajisjes.

Përparësi u jepej fermerëve të cilët gjatë tri viteve të fundit nuk kishin përfituar ndonjë projekt nga komuna apo donatorët në bashkëpunim me komunën. Po ashtu, një përfitues nuk mund të përfitonte më shumë se një projekt brenda vitit dhe nuk mund të ishte përfitues më shumë se një anëtar i së njëjtës bashkësi familjare. Përparësi kishin edhe fermerët të cilët nuk posedonin frezë, spërkatëse gruri apo motokultivator.

Gjatë analizimit të procesit të vlerësimit të thirrjes publike për subvencionimin e fermerëve me pajisje bujqësore, është vërejtur se komisioni vlerësues, në formularin e poentimit, ka përdorur edhe kriterë të tjera të cilat nuk kanë qenë të parapara në Thirrjen Publike. Kriteret shtesë të cilat nuk ishin në thirrjen publike dhe janë shtuar gjatë vlerësimit nga komisioni vlerësues janë: të bjellurat, deklaram i saktë/jo i saktë i fermerëve, dokumentet e kompletuara. Për secilin kriter ishte përcaktuar poentimi me pikë. Përdorimi i këtyre kriterëve tregon se procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike nga ana e komisionit vlerësues.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të kriterëve të përcaktuara në shpalljen publike gjatë vlerësimit të procesit nga ana e komisionit vlerësues.

Ndikimi

Subvencionimi i fermerëve me pajisje bujqësore, duke përdorur kriterë të cilat nuk kanë qenë të shpallura në thirrje, mund të dëmtojë transparencën, pasi janë aplikuar kriterë që nuk ishin të përcaktuara në Thirrjen Publike dhe për të cilat aplikuesit nuk kanë qenë të njoftuar.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë që Komisioni Vlerësues të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve në pajtim me kriteret e përcaktuara në Thirrjen Publike në mënyrë që mos të shtohen pastaj kriterë gjatë procesit të vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Tejkallim i afatit ligjor për pozitat me ushtrues detyre**Gjetja**

Neni 35 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik specifikonte “ Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm”.

Vlenë të theksohet se ky ligj ishte në fuqi për rastet që ne po i trajtojmë, më pas në qershor të vitit 2025 ishte ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik i cili parash se Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve.

Ne kemi identifikuar se në dy (2) raste pozitat e rregullta të punës mbaheshin me Ushtrues Detyre, që tejkallonin afatin e paraparë ligjor. Për këto pozita, nuk ishte shpallur konkurs gjatë vitit 2025 edhe përkundër faktit se ishin përfshirë në planin vjetor të personelit për rekrutim.

Pozita Udhëheqës/e të Sektorit për Çështje Pronësore mbahej me ushtrues detyre nga periudha prej 06.09.2024 deri më 05.03.2025 si dhe prej 06.03.2025 deri më 05.09.2025. Kjo pozitë po ashtu kishte vazhduar të mbahej me ushtrues detyre prej 26.11.2025 deri më 16.06.2026.

Pozita Udhëheqës/e të Sektorit Ligjor mbahej me ushtrues detyre nga periudha prej 02.10.2024 deri më 01.04.2025 si dhe prej 08.05.2025 deri më 07.11.2025.

Kjo ka ndodhur për shkak se nuk kishte kërkesa nga njësia përkatëse për shpallje të konkursit për plotësim të pozitave me staf të rregullt.

Ndikimi

Mbajtja e pozitave me Ushtrues Detyre për një kohë më të gjatë se afati i paraparë ligjor rrezikon që pozitat e ndryshme të mbahen nga zyrtarë të cilët nuk i përmbushin kriteret e kërkuara për pozitat adekuate. Po ashtu, mungesa e zyrtarëve me mandat të rregullt në pozita kyçe udhëheqëse rrezikon në dobësimin e kontrolleve të brendshme, vendimmarrjen afatgjatë dhe llogaridhënien.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojnë që të ndërmerren veprimet e nevojshme për të plotësuar pozitat e rregullta të punës përmes procedurave të rekrutimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe të evitohet praktika e mbulimit të këtyre pozitave me ushtrues detyre përtej afateve ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e obligimeve të papaguara.**Gjetja**

Neni 39.1 i LMFPP-së parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në tri (3) mostra të obligimeve të papaguara në vlerë prej 81,177€, kemi vërejtur se komuna nuk kishte kryer pagesën e obligimeve brenda 30 ditësh nga periudha e përcaktuar ligjore. Vonesat në pagesën e faturave të obligimeve të papaguara ishin deri në 40 ditë pas përfundimit të afatit ligjor.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballlet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat tatimore dhe jo tatimore të realizuara nga Komuna e Klinës në vitin 2025 ishin gjithsej 1,408,790€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjobat e gjykatave dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 643,980€.

Çështja B4 - Mos përmbushja e detyrimit ligjor për verifikim të 20% të objekteve/pronave të tatimpaguesve

Gjetja

Neni 15 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, paragrafi 2 përcakton se “Komuna çdo vit inspekton të paktën njëzet për qind (20) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese mund të angazhojë edhe inspektues privat”.

Komuna për vitin 2025 në raportin financiar për tatimin në objekte nga sistemi Protax, kishte të regjistruar 9,527 objekte. Ne kemi identifikuar se komuna nuk kishte arritur të kryente inspektimin/verifikimin e 20% të objekteve sipas kërkesave ligjore, por kishte inspektuar/verifikuar vetëm 849 të objekteve apo afër 9%.

Bazuar në konfirmimet dhe raportin vjetor të zyrës komunale për tatimin në pronë për vitin 2025, kjo kishte ndodhur për shkak se gjatë gjithë vitit kishte pasur problem me sistemin e ri të tatimit në pronë i cili sistem menaxhohet nga MFTP, pasi sistemi pothuajse nuk kishte funksionuar. Po ashtu, kishte pasur mungesë të stafit për vlerësim të pronës së paluajtshme.

Ndikimi

Mos arritja e kuotës ligjore për inspektim të objekteve rezulton me mos përditësim dhe informata jo të plota për pronën e tatueshme, si dhe mund të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktivitetit për inspektim/verifikim të objekteve dhe sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë

Gjetja

Neni 12 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet me akt nënligjor.

Nga auditimi i të dhënave të tatimit në pronë të viteve paraprake, ishin identifikuar 1,846 tatimpagues të objekteve, të cilëve në data bazë ju mungon numri personal, që në bazë të emrave, mbiemrave dhe emrit të prindit, mund të jenë potencialisht përfitues të disa hershëm nga zbritja e lejuar ligjore. Nga ky numër, në vitin 2025 komuna kishte arritur që 50 tatimpagues t'i identifikonte dhe regjistronte me numër personal. Po ashtu,

baza e të dhënave të tatimit në pronë për vitin 2025 nuk kishte të dhëna për zbritjen për vendbanim parësor, për dallim nga vitet paraprake.

Kjo kishte ndodhur si rrjedhojë e kontrolleve jo të duhura dhe monitorimit të sektorit në pronë, për të bërë verifikimin e tatimpaguesve dhe azhurnimin e të dhënave për numrat personal. Ndërsa sipas raportimit të zyrës së tatimit në pronë, mungesa e të dhënave në data bazë për përfituesit e zbritjes për vendbanim parësor kishte ndodhur për shkak të problemeve me sistemin e tatimit.

Ndikimi

Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat personal të tatimpaguesve mund të ndikoj në përfitim të paligjshëm të disahershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor. Ndërsa mungesa e të dhënave në data bazë për përfituesit e zbritjes për vendbanim parësor, paraqet dobësi për evidentimin e tatimpaguesve përfitues.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve dhe me të dhëna të përfituesve të zbritjes së vendbanimit parësor, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,954,035€, prej tyre ishin shpenzuar 4,616,593€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e objekteve arsimore dhe shëndetësore, banimit social, rregullimin e parqeve.

Çështja B5 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

- Gjetja** Rregullorja Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik neni 70.24 pika (f) thekson se menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik”.
- Nga mostrat e testuara kemi identifikuar se në tri (3) raste menaxhimi i kontratave nuk është mbajtur përmes platformës së e-prokurimit si dhe nuk është kryer vlerësimi i performancës së kontraktorëve.
- Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontroleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes modulit të e-prokurimit.
- Ndikimi** Mosmenaxhimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të marr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.
- Rekomandimi B5** Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e kontratave për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna në RVF ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 5,510,969€.

Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27. Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave. Po ashtu në Aktvendimet për ushtrimin e veprimtarisë afariste apo profesionale përcaktohet se pagesa e ngarkesës së caktuar bëhet në dy këste: Kësti i parë bëhet deri më 15.06 të vitit aktual, ndërsa Kësti i dytë bëhet deri më 15.12 të vitit aktual.

Në vitin 2025, totali i llogarive të arkëtueshme të komunës arriti në 5,510,969€, ku pjesëmarrjen më të madhe ka kanë borgjet nga tatimi në pronë në vlerë 3,977,048€, si dhe taksat për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 1,269,234€. Përveç këtyre, janë edhe të arkëtueshmet nga qiratë për banesa dhe lokale, në vlerë prej 264,687€.

Edhe përkundër faktit se gjatë vitit 2025 komuna kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e borxheve duke dërguar vërejtje dhe letërkujtesa tek borxhlinjtë Llogaritë e arkëtueshme në total krahasuar me vitin paraprak (3,384,665€), janë rritur në 2,126,304€, apo rreth 63%. Rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë si dhe tek taksat për ushtrimin e veprimtarisë.

Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

Ndikimi

Mosrealizimi i të hyrave të planifikuara rrit rrezikun e dështimit të projekteve të financuara nga burimet vetanake. Gjithashtu, vjetërsia e llogarive të arkëtueshme e vështirëson, apo në disa raste e bën të pamundur, mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B6

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të intensifikojnë veprimet dhe ndërmarrin të gjitha masat për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe zvogëlimin e trendit të tyre rritës ndër vite.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mosazhurnimi i kontratave të qirasë për lokale afariste pas skadimit të afatit kontraktual

Gjetja

Kontratat për shfrytëzimin e lokaleve afariste me qira ishin lidhur për periudha të ndryshme kohore, duke filluar nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Sipas kontratës parashihet që pas përfundimit të periudhës kontraktuese, bëhet vlerësimi për vazhdimin apo ndërprerjen e kontratës.

Kemi vërejtur se në gjashtë (6) raste komuna nuk ka bërë vlerësimin dhe vazhdimin e kontratave të qirasë pas skadimit të afatit të tyre, duke bërë që kontratat e lidhura ndër vite të mbeten të pa azhurnuara dhe pa ripërtërije, pavarësisht përfundimit të periudhës së shfrytëzimit të përcaktuar me kontratë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve joefektive në komunë për menaxhimin, monitorimin dhe azhurnimin me kohë të kontratave të qirasë për lokale afariste.

Ndikimi

Kjo ndikon që komuna të ketë shfrytëzim të lokaleve afariste pa bazë të vlefshme kontraktuale, humbje të mundshme të të hyrave, si dhe mungesë të sigurisë juridike dhe menaxhimit efektiv të pronës komunale.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha kontratat për shfrytëzimin e lokaleve afariste të rishikohen dhe të azhurnohen me kohë, në mënyrë që vazhdimi i shfrytëzimit të bëhet vetëm mbi bazën e kontratave valide dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre.

Çështjet të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1 **Gabimet e identifikuar dhe pasaktësitë e prezantuara në draft PFV**

Gjetja

Te neni 14 Raporti i ekzekutimit buxhetit pjesa hyrja e parasë në LLVTH kolona realizimi- Te Shënimi 9 - Të hyrat jo tatimore, komuna ka përfshirë gabimisht edhe të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe dënimet e policisë si të hyra vetanake. Kjo paraqitje nuk është në përputhje me kërkesat e raportimit, pasi komuna duhet të prezantojë vetëm të hyrat jo tatimore të inkasuara nga vetë komuna. Si rezultat, ky korrigjim duhet të reflektohet edhe te Shënimi 9 i shpalosjeve në faqen 15. Të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe dënimet e policisë duhet të shpalosen vetëm në formë përshkruese (me fjalë) nën tabelën e Shënimit 9 në faqen 15, dhe jo të përfshihen në vlerën totale të të hyrave jo tatimore të komunës. Sipas SIMFK-së, vlera e saktë e të hyrave jo tatimore është 821,514€, ndërsa në këtë shënim është prezantuar vlera 1,465,521€, duke rezultuar në një diferencë prej 644,007€. Prandaj, kërkohet korrigjimi i këtij shënimi dhe harmonizimi i tij me të dhënat e SIMFK-së.

Te shënimet shpjeguese sipas kategorive ekonomike, kërkohet që të analizohen dhe rishikohen edhe një herë të dhënat e prezantuara, pasi buxheti final nuk është paraqitur saktë në këto shënime për të gjitha kategoritë ekonomike.

Te neni 21 Raporti për të hyrat vetanake të pashpenzuara, të hyrat e pranuar në vitin 2025 nuk i keni vendosur drejt dhe saktë. Këtu duhet t'i vendosni të gjitha të hyrat që ka realizuar komuna, duke përfshirë edhe gjobat e gjykatave dhe dënimet e policisë, që totali sipas shënimeve të SIMFK-së është 1,465,521€. Nga ekzaminimi fizik te projekti "Shtëpia për përkujdesjen e personave të moshuar" kemi vërejtur se nuk ishin vendosur 4 kamera, elemente të kuzhinës, 12 dyer dhe 4 sisteme alarmi, si dhe te projekti "Ndërtimi dhe rindërtimi i objektit sportiv të kulturës" nuk ishin vendosur 10 led drita ndriçues. Pas komunikimit me menaxhmentin, ishin ndërmarrë masa të menjëhershme dhe mjetet monetare për dyer ishin kthyer në llogari të komunës, ndërsa pajisjet tjera ishin vendosur.

Me rastin e korrigjimit të pasqyrave financiare, i kushtoni vëmendje edhe çështjeve që kërkojnë të adresohen me prioritet. Pasuritë e regjistruara në klasën e pasurive si investime në vijim në fund të vitit 2025 në regjistra kontabël arrinin vlerën prej 2,249,246€. Pasuritë në regjistrin e pasurive në klasën e pasurisë investime në vijim datojnë që nga viti 2023. Për pasuritë ku projektet janë përfunduar dhe janë në shfrytëzim, duhet të ndërmerren masa që këto pasuri të regjistrohen në klasat përkatëse të pasurive dhe të mbyllet klasa kalimtare e pasurisë si investime në vijim, për të siguruar një prezantim të drejtë dhe korrekt të pasurive në regjistra kontabël dhe në pasqyra vjetore financiare.

Veprimi i kërkuar

Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për eliminimin e çështjeve të identifikuara, si dhe të bëjë korrigjimin e Pasqyrave Financiare Vjetore, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Rezultati

Menaxhmenti kishte marrë veprime të menjëhershme duke bërë eliminimin e çështjeve të identifikuara, si dhe të disa pasaktësive të identifikuara nga ne në PFV. Për gabimet e pakorrigjuara në PFV, ne i kemi prezantuar dhe kemi dhënë rekomandime.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	16,168,653	17,193,525	16,743,540	15,408,878	14,691,283
Grante Qeveritare - Buxheti	14,673,149	14,826,714	14,702,861	13,261,524	12,048,247
Të bartura nga viti i kaluar	0	624,855	525,589	834,666	1,227,234
Të hyrat vetanake	1,495,504	1,495,504	1,326,325	1,249,988	951,375
Donacionet vendore	0	80,384	25,272	62,699	37,023
Donacionet e jashtme	0	166,067	163,492	0	427,403

Buxheti final i Komunës së Klinës është më i lartë se buxheti fillestar për 1,024,872€. Kjo rritje e buxhetit është i rezultat i vendimit të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 153,566€, të hyrave vetjake të bartura prej 624,855€ dhe donacionet në vlerë 246,451€.

Komuna ka shpenzuar rreth 97% të buxhetit final e cila paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	16,168,653	17,193,525	16,743,540	15,408,878	14,691,283
Pagat dhe mëditjet	8,892,032	9,045,597	9,044,041	8,092,429	7,406,952
Mallrat dhe shërbimet	1,700,000	1,794,000	1,733,145	1,761,497	1,716,951
Komunalitë	370,000	460,000	459,514	269,888	235,176
Subvencionet dhe transferet	800,000	939,892	890,246	679,857	420,963
Investimet Kapitale	4,406,621	4,954,035	4,616,593	4,605,207	4,911,241

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje me vendim të qeverisë ishte rritur për 153,565€, krahasuar me buxhetin fillestar.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 94,000€. Kjo rritje vjen si rritje nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2024 në vlerë prej 90,000€ dhe donacioneve prej 4,000€.


Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për furnizime, pasje të teknologjisë informative, mirëmbajtje dhe servisim, pastrim të objekteve, mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve.

Buxheti final për komunalitet është rritur për 90,000€, nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2024.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 139,892€. Kjo rritje vjen si rritje nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2024 në vlerë prej 92,747€ dhe donacioneve prej 47,145€. Shpenzimet kanë të bëjë me pagesat e bëra për përkrahjen e OJQ-ve, të individëve si dhe për përkrahjen e fermerëve.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 547,414€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2024 për 352,108€, si dhe rritje nga donacionet për 195,306€. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin e objekteve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat tatimore dhe jo tatimore të realizuara nga Komuna e Klinës në vitin 2025 ishin gjithsej 1,408,790€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjobat e gjykatave dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 643,980€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	1,495,504	1,495,504	1,408,790	1,289,661	1,385,801
Të hyrat tatimore	597,436	597,436	586,708	550,999	621,791
Të hyrat jo tatimore	898,068	898,068	821,514	737,789	764,010
Të hyrat tjera	0	0	569	873	

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024, kishte rezultuar me tetë (8) rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2024 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë, një (1) rekomandim ishte zbatuar, një (1) pjesërisht i zbatuar dhe gjashtë (6) rekomandime nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luaj një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të komunës, në mënyrë që këto kontrata të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit. Po ashtu duhet të siguroj që të mos tejkalohen sasisë e parashikuara me kontratë.	Edhe gjatë vitit 2025 kishte tejkalim në realizimin e sasive të kontratës publike kornizë, në mospërputhje me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit.	Nuk ka filluar zbatim

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Komuna edhe për vitin 2025 nuk ka arritur të përmbushë kuotën ligjore për inspektim të objekteve.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që para inicimit të procedurave të prokurimit së pari projektet të jenë të detajzuara dhe të ekzekutueshme, të përcaktohet volumi dhe afatet reale për përfundimin e punëve, si dhe paraprakisht të zgjidhen problemet pronësore në vendet ku duhet të kryhen projektet. Po ashtu, duhet të siguroj që menaxherët e kontratave të mbikëqyrin realizimin e projekteve për të eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara.	Nga testimi i mostrave tona nuk kemi hasur gjetje të kësaj natyre.	I zbatuar
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.	Rekomandimi është zbatuar pjesërisht nga se ende vazhdojnë mangësitë për numrat personal të tatimpaguesve në sistemin protax.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.	Edhe gjatë vitit 2025, ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve, prandaj kemi konkluduar se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.	Edhe pse entiteti kishte ndërmarrë veprime për menaxhimin e kontratave përmes sistemit të e-prokurimit, ende ka raste që kontratat nuk menaxhohen përmes platformës elektronike e-prokurimi si dhe nuk bëhet vlerësimi i performancës së kontraktorëve.	Nuk ka filluar zbatimin

7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të intensifikojnë veprimet dhe ndërmarrin të gjitha masat për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe zvogëlimin e trendit të tyre rritës ndër vite.	Gjendja e llogarive të arkëtueshme krahasuar me vitin paraprak është rritur, dhe gjetja është e njëjtë sikur vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Jetmira Isufi, Anëtare e ekipit



Arlinda Rahmani, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,


Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Klinës, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z.

Zenun Elezaj, kryetar i komunës

Data: 2.06.2026, Klinë,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Loti 1- Mirëmbajtja dhe hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollave që ka të bëjë me punët e suvatimit, ngjyrosjen e mureve të brendshme dhe të jashtme me çmim të përgjithshme 210,000€; Lot 2- Mirëmbajtja dhe hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollave që ka të bëjë me punët e sanimit të rrethojave të jashtme, me çmim të përgjithshme 10,000€; Lot 3- Mirëmbajtja dhe hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollave që ka të bëjë me punët elektrike me çmim të përgjithshme 10,000€; dhe Lot 4- Mirëmbajtja dhe hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollave që ka të bëjë me punët e hidroinstalimeve me çmim të përgjithshme 30,000€.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.